

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstvo / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova
National Institute of Public Health of Kosovo

Njësia org. _____
Org. Jedin. _____
Org. Unit _____
Nr. i faqeve _____
Br. Shën. _____
Nr. _____

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No _____
Data _____
Datum _____
Datë _____

14 2004 25/08/2015



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Marrëveshje e Mirëkuptimit për bashkëpunim reciprok

ndërmjet palëve nënshkruese:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

dhe

Radiotelevizioni i Kosovës

Prishtinë, Gusht 2015

Faqe 1 nga 7



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**



**RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO**

I. BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bazohet në:

1. Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
2. Ligjin Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike.
3. Planin e veprimit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor 2023-2025.
4. Ligjin Nr. 04/l-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.
5. Ligjin Nr. 08/L-205 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.
6. Aktet juridike tjera të ndërlidhura dhe
7. Aktet e Brendshme Rregullative të RTK-së.

II. PALËT NËNSHKRUESE

1. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (në tekstin e mëtejme IKShPK) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike, përfshirë promovimin dhe edukimin shëndetësor. Si institucion më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës, IKShPK organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë. Selia e IKShPK është në rr. Instituti Shëndetësor nr. 12, rrethi i spitalit, Prishtinë.
2. Radiotelevizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK) është transmetues publik i Kosovës. RTK është person juridik jo profitabil me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme i cili ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale. RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues. Selia e RTK është në rr. "Xhemail Prishtina" nr. 12, Prishtinë.

Faqe 2 nga 7



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

III. QËLLIMI I MARRËVESHJES

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje kanë për synim mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve në Kosovë, përmes edukimit dhe promovimit shëndetësor i cili rrit vetëdijen për shëndetin dhe ndihmon që të përvetësohen dhe avancohen shprehitë e shëndosha të jetesës.
2. Përmes edukimit dhe promovimit shëndetësor synohet të arrihet ofrimi dhe shpërndarja e rregullt e informatave shëndetësore të cilat promovojnë modele dhe standarde të bazuara në evidenca shkencore dhe praktika të mira të përvojave profesionale, në funksion të edukimit dhe promovimit shëndetësor.
3. Bashkëpunimi reciprok i palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje bëhet me qëllim të parandalimit të paraqitjes së sëmundjeve, menaxhimit të sëmundjes dhe parandalimit të pasojave të tyre.

IV. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunojnë për produkte mediale që transmetohen në rrjetin e Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për të:

1. Realizuar emisionin televiziv periodik (të përcaktohet në koordinim me RTK) dhe të vazhdueshëm për edukim dhe promovim shëndetësor.
2. Realizuar podcaste periodike (të përcaktohen në koordinim me RTK) dhe të vazhdueshme për edukim dhe promovim shëndetësor.
3. Mbuluar aktivitetet e zhvilluara gjatë Ditëve Ndërkombëtare dhe fushatave për Shëndetin si dhe ngjarjet tjera me rëndësi për shëndetin publik në programet dhe platformat e ndryshme të RTK-së.



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**



**RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO**

V. DETYRAT DHE OBLIGIMET E IKShPK

IKShPK do të jetë përgjegjëse për:

1. Konceptin e emisionit televiziv edukativo-shëndetësor, temat e trajtuara, skenarin, përzgjedhjen e mysafirëve, udhëheqjen e emisionit, dhe të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me përmbajtjen e emisionit.
2. Konceptin e podcastit, temat e trajtuara, skenarin, përzgjedhjen e mysafirëve, udhëheqjen e episodeve, dhe të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me përmbajtjen e podcastit.
3. Përzgjedhjen e sekuençave të shkurtra nga emisioni televiziv/podcasti, për t'u publikuar në rrjete mediale të RTK-së dhe IKShPK-së, ndërsa Youtube i takon vetëm RTK-së. Kjo përzgjedhje nuk mund të përfshijë përcaktimin e datave të emetimit – sepse përcaktimi i datave dhe orareve është e drejtë ekskluzive e RTK-së.
4. Respektimin e rregullave të punës të RTK, respektivisht politikave redaktuese.
5. Informimin paraprak të RTK-së për datat e Ditëve Botërore të Shëndetit dhe ngjarjet tjera me interes për shëndetin publik, për të cilat nevojitet mbulueshmëri mediale.

VI. DETYRAT DHE OBLIGIMET E RTK

RTK do të jetë përgjegjëse për:

1. Ofrimin e hapësirës mediale për emisionin edukativo-shëndetësor, minutazhën, terminin e emetimit, studion, ndriçimin, zërimin, skenografinë, stafin realizues në studio dhe teren sipas nevojës, montazhin dhe të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me realizimin, prodhimin dhe emetimin e emisionit.

Faqe 4 nga 7



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

2. Ofrimin e hapësirës mediale për podcaste, minutazhën, terminin e emetimit, studion, ndriçimin, zërimin, skenografinë, stafin realizues, montazhin dhe të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me realizimin, prodhimin dhe emetimin e podcastit në bazë të politikave redaktuese të RTK-së.
3. Emetimin e sekuencave të shkurtra nga emisioni edukativo-shëndetësor dhe podcasti, për tu publikuar në rrjete mediale të RTK-së, edhe kur kjo kërkohet nga IKShPK, ky emetim bëhet në datat e caktuara të ditëve botërore të shëndetit.
4. RTK do të respektojë parimin e profesionalizmit, konfidencialitetit dhe të drejtave të njeriut nëse gjatë realizimit të emisionit/podcastit do të hasë në të dhëna personale shëndetësore të ndonjë individi.
5. Mos reklamim të produkteve të dëmshme për shëndetin; për blerje të ndonjë produkti shëndetësor; apo për shfrytëzim të institucioneve shëndetësore private brenda dhe jashtë vendit gjatë emisionit edukativo-shëndetësor/podcastit.

VII. DETYRAT DHE OBLIGIMET E PALËVE

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje pajtohen që të marrin detyrat dhe obligimet e përbashkëta:

1. Palët do të emërojnë personat përgjegjës, nga një për secilën palë, si pikë kontakti për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve për realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.
2. Palët do të mbajnë takime të rregullta, të nevojshme për të diskutuar në detaje konceptin e secilit emision dhe çështje tjera të ndërlidhura.
3. Palët janë të lira të marrin pjesë në të gjitha aspektet e bashkëpunimit dhe të bëjnë sugjerime përkatëse. Në rast të mospajtimeve, mbizotëron vendimi i palës e cila i ka detyrat dhe obligimet për atë çështje sipas kësaj Marrëveshjeje.



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**



**RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO**

4. IKSHPK mban pronësinë intelektuale (idenë dhe autorësinë) mbi produktet që dalin si rezultat i këtij bashkëpunimi ndërsa RTK mban pronësinë prodhuese audio-vizuale mbi të njëjtat. RTK nuk ka asnjë obligim financiar ndaj IKSHPK për ritransmetime të këtyre produkteve dhe të njëjtat mund të përdoren nga palët nënshkruese sipas marrëveshjes, ndërsa përdorimi nga palët tjera bëhet vetëm me pëlqimin e palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje.

VIII. NDRYSHIMI DHE SHFUQIZIMI I MARRËVESHJES

1. Me nënshkrim të kësaj Marrëveshjeje Mirëkuptimi, palët nënshkruese obligohen për të realizuar në tërësi të gjitha detyrat dhe obligimet e kësaj Marrëveshjeje.
2. Marrëveshja mund të ndryshojë me iniciativën e cilës do nga të dy palët, përmes drejtimit të kërkesës me shkrim palës tjetër. Ndryshimet eventuale të Marrëveshjes evidentohen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dy palët.
3. Palët nënshkruese pajtohen që kjo Marrëveshjeje Mirëkuptimi mund të shfuqizohet nga cilado palë nënshkruese me njoftim paraprak me shkrim dërguar palës tjetër, në afat jo më të shkurtër se 30 ditë.

IX. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Palët nënshkruese pajtohen që kjo Marrëveshjeje Mirëkuptimi të ketë afat deri me 30.08.2026 me mundësi vazhdimi.
2. Nëse palët nënshkruese nuk bëjnë njoftim paraprak me shkrim për palën tjetër në afatin e caktuar në paragrafin 3 të kapitullit VIII, Marrëveshja mbetet në fuqi pas kalimit të afatit të përcaktuar, deri sa njëra palë shfaq dëshirën për ndryshim apo shkëputje të kësaj Marrëveshjeje.



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIJIZA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

X. HYRJA NË FUQI

1. Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi është hartuar në katër (4) kopje identike, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese.
2. Marrëveshja e Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Nënshkruar:

Për IKShPK:

Drejtor Ekzekutiv

Dr. Ardita Baraku



Për RTK:

u.d. i Drejtorit të Përgjithshëm

Hysen Hundozi

Prishtinë: 25/08/2025